



Terapi me psikomotorikë (PMT)

Ndodh që fëmijët të manifestojnë spikatje në fushën e motorikës. Në raste të tilla, fëmijët janë të kufizuar në sjelljet e tyre të lëvizjes dhe të shprehjes si dhe të mësimit. Pjesërisht kanë vështirësi teksa bëjnë planifikimin dhe zbatimin e veprimeve të tyre. Shpesh herë ndodh që të kenë vështirësi, edhe në sajimin e marrëdhënieve adekuate në përditshmëri.

Terapia me psikomotorikë është një ofertë nxitëse pedagogjike-terapeutike për fëmijët, që biejnë në sy përsa i përket zhvillimit të tyre.

Sqarimi i kujdesshëm psikomotorik mund të sjellë qartësi, në qoftë se ju konstatoni spikatjet tek fëmija juaj, me sa vijon:

- Spikatje në baraspeshë dhe në koordinimin e lëvizjeve
- Vështirësi gjatë të sajuarit me dorë, të vizatuarit dhe të shkruarit
- Kohëzgjatje e shkurtër e vëmendjes dhe e përqëndrimit të tyre
- Vetbesim i mangët, sjellje frikacake, sjellje ngurruese ose prej një fëmije të vogël
- Vështirësi gjatë marrëdhënieve me fëmijët e tjerë
- Shqetësime, pëngesa, vështirësi për të respektuar rregulla

Sqarim psikomotorik: Vëzhgim dhe biseda

Në kuadër të sqarimit psikomotorik bëjnë pjesë edhe vëzhgimet e fëmijës gjatë situatave të lira dhe të strukturuar të lojës dhe të lëvizjeve, por edhe bisedat me fëmijën, me prindërit dhe me persona të tjerë përkatës. Në rastet kur ka probleme në të shkruar ose kur ka një pasiguri lidhur me të shkruarit me dorë të majtë gjegjësisht të majtë, do të bëhet një sqarim enkas për këtë.

Në bazë të rezultateve të sqarimeve ne vendosim në bashkëpunim me prindërit, se a do të ishte fitimprurëse një mbështetje terapeutike.

Fëmija do të gjejë mbështetje

- në sensin e pavarësisë dhe të aktivitetit vetanak
- në forcimin e vetbesimit
- në zbulimin dhe në zhvillimin më tej të aftësive dhe të shkathtësive personale
- në zgjerimin e kompetencave në të lëvizur në lëmin e trashë, të hollë si dhe grafomotorik
- në diferencimin e perceptimit të senseve dhe të ndjenjës perceptuese fizike
- në zhvillimin e strategjive të reja dhe të mundësive për zgjidhjen e problemeve në ballafaqimin me problemet, me veprimet si dhe me materialin
- në zgjerimin e kompetencave sociale dhe të aftësisë së komunikimit

Terapia me psikomotorikë:

Të lozurit, të shprehurit, të përpunuarit

Puna në kuadër të terapisë me psikomotorikë orientohet në temat personale të zhvillimit të fëmijës, në sjelljen individuale të fëmijës në kuptim të të lozurit dhe të të lëvizurit, në aftësitë e tij dhe në botën e tij të përjetimeve.

Në terapinë e psikomotorikës ne punojmë me oferta joshëse të lëvizjes: në lojë, me muzikë, me material specifik dhe me mjete krijuese të të shprehurit. Në këtë mënyrë, fëmija do të mund të njoftojë në një kornizë të mbrojtur aftësitë e saj si dhe kufijtë e saj. Fëmija i zgjeron kështu edhe shkathtësitë, duke mësuar se si t'i qaset vështirësive.

Nëpërmjet lojërave të lëvizjes dhe të simboleve, fëmija do të mësojë se si t'i përpunojë përjetimet e saj, ndjenjat dhe se si t'i shpreh dhe t'i përpunojë konfliktet.

Fëmijët e vizitojnë orën e terapisë me psikomotorikë në mënyrë teke ose në grupe të vogla.

Qëllimi: lëvizje e kontrolluar, zhvillim social

Terapia me psikomotorikë e nxit fëmijën tuaj në lëmim e lëvizjes dhe të perceptimit. Njëkohësisht ajo e mbështet zhvillimin e saj social dhe emocional, në mënyrë që fëmija të gjejë vetën më kollaj në përditshmërinë e jetës.

Personat përkatës kontaktues do të përfshihen gjithashtu: gjatë bisedave këshilluese ato do të mësojnë një qasje të përshtatshme dhe frytdhënëse për të dyja palët me të gjithë veçoritë e fëmijës.